

LIGJ
Nr. 41/2018

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN
E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 113, pika 1, shkronja “ç”, 155 dhe 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.”.

Neni 2

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

Miratuar në datën 9.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10844, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta